

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

MIRATIMIN PLANIT TË VEPRIMIT 2024-2026 NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SIGURISË NË KOMUNITET 2021-2026”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka si qëllim miratimin e Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, pas përfundimit të afatit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2023. Ky plan veprimi shërben si një instrument për të bashkërenduar të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshetërorë, si dhe partnerët ndërkombëtarë që ndihmojnë e mbështesin vendin tonë në kuadër të sigurisë publike në komunitet.

Qëllimi i këtij projektvendimi është bashkërendimi, koordinimi dhe harmonizimi i përpjekjeve e nismave të të gjithë institucioneve në vend, duke krijuar kuadrin e nevojshëm për bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve, përmes roleve e përgjegjësive të tyre institucionale si dhe synon të përcaktojë orientimet politike që duhen ndërmarrë nga institucionet për parandalimin e të gjitha formave të kriminalitetit, duke bashkëvepruar me komunitetin për gjetjen e zgjidhjeve me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë dhe adresimin e sfidave tek institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor.

Gjithashtu, synohet forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe trajtimin në kohë të problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet si uljen e kriminalitetit/sjelljeve anti shoqërore në komunitet, uljen e veprave

penale që cenojnë sigurinë në komunitet, parandalimit të orientuar nga inteligjenca dhe informacioni, parandalimin dhe adresimin e problematikave në shkollë nëpërmjet ndërveprimit me mësuesit, drejtuesit e shkollës dhe Policisë (SPZ), parandalimin nëpërmjet zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla dhe rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet nëpërmjet sigurisë rrugore dhe kontrollit të territorit.

Plani i ri i Veprimit synon reflektimin e përgjegjësive të strukturave, në nivel qendror dhe atij vendor që kanë përgjegjësi në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Për këtë arsye, përmes këtij projektakti do të synohet të analizohet në nivel strategjik kuadri ligjor ekzistues, kuadri konceptual dhe procedural, modelet e vendeve me të përparuara evropiane si dhe do të identifikohen aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë sigurinë publike. Gjithashtu, do të analizohet dhe arkitektura institucionale në nivel qendror dhe vendor si dhe përgjegjësitë përkatëse të institucioneve në fushën e sigurisë, koordinimi mes tyre, mekanizmat që mund të ngrihen për parandalimin e të gjitha formave të kriminalitetit, duke bashkëvepruar me komunitetin për gjetjen e zgjidhjeve me qëllim rritjen e parametrave të sigurisë dhe adresimin e sfidave tek institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor për trajtimin e rasteve në kohë.

Përmes këtij projektakti në nivel lokal do të synohet konsolidimi i Këshillave Vendor të Sigurisë Publike, fuqizimi i rolit të vetëqeverisjes vendore në sigurinë publike si dhe përfshirja aktive e komunitetit në çështjet e sigurisë publike.

Dokumenti i Planit të Veprimit 2024-2026 është pasuruar me masa konkrete për realizimin e objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën e sigurisë publike. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026.

Miratimi i këtij projekt-akti është diktuar nga nevoja e përfundimit të afatit të zbatimit të Planit të Veprimit 2021-2023 të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026.

Gjithashtu, ky projektakt është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Brendshme, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2024, në katërmujorin II.

Projektvendimi është në përputhje me nenin 100, pika 1 e Kushtetutës, ku përcaktohet se Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore; vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Brendshme”. ku përcaktohet se Ministria e Brendshme”, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi është institucioni përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Plani i Veprimit 2023-2026 është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE III) 2021-2030, i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integritetit të saj në Bashkimin Evropian si dhe është në përmbushje të parashikimeve të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) 2022-2024, kapitulli, 24, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, ndaj miratimi i këtij projektvendimi, do të plotësojë realizimin e angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar dhe ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Politikat dhe objektivat specifike të këtij dokumenti politik, janë në përputhje me disa prej Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe Agjendës 2030, respektivisht:

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe; 3.6 të përgjysmohet numri global i vdekjeve dhe i plagosjeve nga aksidentet rrugore;

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave; 5.1 T’i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave; 5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit;

Objektivi 11: Ndërtimi i qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të parrezikshme, rezistente dhe të qëndrueshme; 11.2 Të sigurohet për të gjithë qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përballueshëm, të arritshëm dhe të qëndrueshëm, duke përmirësuar sigurinë rrugore, sidomos duke zgjeruar shërbimin e transportit publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të personave në gjendje të pambrojtur, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve;

Objektivi 16: Paqe, drejtësi, institucione të forta; 16.1 Kudo të zvogëlohen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe numri i vdekjeve si rezultat i dhunës; 16.6 Të zhvillohen institucione efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet; 16.10 Të sigurohet e drejta e publikut për të marrë informacion dhe të mbrohen liritë themelore të njeriut, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Brendshme në bashkëpunim me institucionet e tjera e përfshira në Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 në rolin e institucionit lider, ka hartuar Planin e Veprimit 2024-2026 dhe ka planifikuar masa konkrete për të parandaluar dhe garantuar sigurinë në komunitet.

Plani i Veprimit 2024-2026, parashikon masa që duhet të realizohen sipas afateve të përcaktuara në dokument, me qëllim realizimin e qëllimeve politike dhe objektivave specifike të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026.

Projektakti ka si qëllim jetësimin dhe realizimin në kohë dhe më cilësi të 3 qëllimeve strategjike, duke synuar rritjen e parametrave të sigurisë në komunitet, angazhimin dhe ndërveprimin me komunitetin, si dhe reformimin e shërbimit policor dhe rritjen e kapaciteteve për policimin në komunitet, të cilat synohet të arrihen duke zbatuar masat nga institucionet përgjegjëse brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu ky plan do të synojë adresimin e problematikave me të cilat shoqëria jonë, por edhe vendet e tjera ballafaqohen nëpërmjet analizimit të kuadrit ligjor dhe institucional, realizimit të bashkëpunimit ndërinstucional për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e rasteve. Duke zbatuar këtë

vizion, ne do të kemi komunitete të sigurta, të emancipuara dhe gjithëpërfshirëse.

Plani bazohet edhe në raportin e vlerësimit 3-vjeçar të Planit të Veprimit të Sigurisë në Komunitet 2021-2023 për të krijuar vijueshmëri dhe reflektuar në mënyrë adekuate masat e perealizuara dhe ato të realizuara pjesërisht si edhe për të përfshirë dhe përpunuar masa të cilat janë raportuar të realizuara por që konsistojnë në objektiva e veprimtari të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve institucionale dhe financimi i tyre i përshtatshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i paraqitur është në harmoni me rendin juridik të brendshëm. Ai është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe veçanërisht nenin 100 të saj, sipas të cilit ndër të tjera përcaktohet se, “*Këshilli i Ministrave merr vendime për përcaktimin e drejtimeve kryesore të politikës shtetërore*”, vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme*”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk përfron në vetvete një akt të legjislacionit të Bashkimit Evropian, por do të shërbejë si instrument për adresimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian për përfrimin me *acquis communautaire* për fushën e rendit dhe sigurisë publike.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projekti është hartuar sipas Vendimit nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)” dhe përmban 3 qëllime politike si më poshtë:

1. Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet;
2. Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin;
3. Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet.

Qëllimet kryesore të këtij dokumenti janë evidentimi, parandalimi i krimit, ndërgjegjësimi/edukimi rreth çështjeve të sigurisë, përfshirja dhe ndërveprimi me komunitetin komunitetit në çështjet e sigurisë si dhe bashkëpunim ndërinstitucional dhe fuqizimi i rolit të organeve të vetëqeverisjes lokale.

Plani i Veprimit përbëhet nga 3 drejtime kryesore, të cilat ndahen në disa objektiva specifike, si dhe masa të përcaktuara në përmbushje të tyre. Hartimi i këtyre objektivave, masave dhe aktiviteteve është bërë në bashkëpunim të ngushtë dhe gjithëpërfshirës me institucionet që kanë kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Qëllimi i Politikës I “*Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet*” përmban 3 objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi specifik 1.1: Rritja e sigurisë në komunitet bazuar në vlerësimin e risqeve dhe proaktivitetin;

Objektivi specifik 1.2: Evidentimi, parandalimi dhe trajtimi në kohë i problematikave të komunitetit dhe çështjeve të rëndësishme që cenojnë rendin dhe sigurinë në komunitet;

Objektivi specifik 1.3: Rritja e efikasitetit të kontrollit të territorit.

Qëllimi i Politikës II “*Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin*” përmban 3 objektiva specifike si më poshtë:

Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i komunikimit me publikun;

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin nëpërmjet funksionimit të KVSP-ve;

Objektivi specifik 2.3: Rritja e mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për Sigurinë Publike;

Qëllimi i Politikës III “Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet” përmban 2 objektiva specifikë si më poshtë:

Objektivi specifik 3.1: Përmirësimi i strukturave në shërbim të komunitetit dhe krijimi i një strukture të posaçme të dedikuar për policimin në komunitet;

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kushteve të punës, performancës, kapaciteteve profesionale dhe motivimit të punonjësve të policisë.

Me qëllim realizimin e objektivave specifikë të këtij Plani 2023-2025 institucionet përgjegjëse që ngarkohen me detyrime do të ndërhyjnë në fushat e mëposhtme:

1. Kuadri ligjor rregullator;
2. Kuadri organizativ dhe institucional;
3. Hartim i Procedurave;
4. Ngritje kapacitetesh të Burimeve njerëzore dhe trajnimi;
5. Ngritje kapacitetesh Infrastrukturore.

Disa nga masat kryesore të parashikuara në Planin e Veprimit 2024-2026 në zbatim të Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, janë si më poshtë:

- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstucional për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe masat parandaluese;
- Përmirësimi i sistemit Menaxhimit Policor të Çështjes;
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të Komisarjati Digjital;
- Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit i orientuar nga Inteligjenca dhe Informacioni;
- Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit;
- Siguria e të rinjve në shkolla dhe përgjatë perimetrit të shkollave;
- Siguria e sezonit turistik gjithëvjetor;
- Siguria e komunitetit me fokus të shtrirë në identifikim dhe parandalim;

- Siguria në kuadër të kontrollit të territorit për veprimtari të paligjshme;
- Siguria në kuadër të parandalimit ngacmimeve dhe dhunës seksuale fizike, psikologjike apo në hapësirat kibernetike;
- Siguria e komunitetit në kuadër të menaxhimit të qarkullimit rrugor dhe ndërgjegjësimit;
- Siguria e komunitetit në kuadër të përballimit të emergjencave;
- Institucionalizimi dhe funksionimit të KVSP-ve.
- Analizimi i kuadrit ligjor, organizativ, të sigurisë publike në nivel qendror dhe vendor si dhe përgjegjësitë përkatëse të institucioneve në fushën e sigurisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Plani i Veprimit 2024-2026 të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026 do të zbatohet nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor si ministritë e linjës, prefekturat dhe njësitë e qeverisjes vendore të cilat kanë një rol të veçantë në çështjet e sigurisë në komunitet dhe sigurisë publike.

VIII. INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Nisma për hartimin e këtij projekt-akti është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike, bazuar kjo dhe në fushën e saj të përgjegjësisë të rregulluar me vendimin nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, si dhe në Urdhrin nr. 20, datë 19.01.2024 “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Dokumentit Strategjik për Sigurinë Publike”.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar vazhdimisht takime të grupit ndërinstitutional të punës si dhe janë zhvilluar takime të tryezave teknike me përfaqësues të Policisë së Shtetit, konkretisht, Departamentit të Rendit dhe Sigurisë Publike, Sektorin e Krimeve në Volum, Sektorin e Policimit në Komunitet, Sektorin e Dhunës në Familje, Sektorin e Sigurisë Rrugore, Sallën e Komandës së Kontrollit, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe

Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me ekspertë në fushën e sigurisë publike nga organizatat si IDM, CIDS, dhe Programi Suedez për Policimin në Komunitet.

Ministritë e linjës, institucione të tjera si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit; Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore; Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) kanë dhënë kontributin e tyre për hartimin e Planit të Veprimit 2023-2025.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen nëpërmjet sistemit e-aktet pranë:

- Ministrisë së Drejtësisë;
- Ministrisë së Financave;
- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Ministrisë së Shtetit për Rininë;
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektvendimi dhe relacioni shoqërues do të përcillen me shkresë zyrtare për mendim pranë:

- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm;
- Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare përlllogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit 2024-2026 të kësaj Strategjie.

Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe me buxhetim nga donatorë për zbatimin e Planit të Veprimit 2024-2026 të Strategjisë Ndërsektorale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e Planit të Veprimit 2024 – 2026”, është rreth **14,57** miliardë Lekë, ose rreth **133,7 milionë** Euro.

Qëllimet e politikave	Natyra e kostove	Kosto totale 2024-2026	Kosto e planifikuar në PBA 2024-2026 Buxheti dhe Donatorët	Hendeku financiar 2024-2026
QP1: Rritja e parametrevave të sigurisë	Korente	12,584,831,948	12,584,831,948	15,000,000
	Kapitale	16,680,634	1,680,634	
QP2: Angazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin	Korente	1,424,537,965	1,424,537,965	0
	Kapitale	23,358,105	23,358,105	
QP3: Reformimi i shërbimit policor dhe rritja e kapaciteteve për sigurinë në komunitet	Korente	320,930,974	320,930,974	0
	Kapitale	209,096,316	209,096,316	
TOTALI [Leke]		14,579,435,941	14,564,435,941	15,000,000
TOTALI [Euro] <i>1 euro 109.5 Lekë</i>		133,756,293	133,618,678	137,615

	Kosto Korente	Kosto Kapitale	TOTALI
Qëllimi i Politikës I	12,584,831,948	16,680,634	12,601,512,582
Qëllimi i Politikës II	1,424,537,965	23,358,105	1,447,896,070
Qëllimi i Politikës III	320,930,974	209,096,316	530,027,290


Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 3 viteve të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 - 2025.

Kosto totale e Planit të Veprimit	14,579,435,941
Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026	14,355,339,625
Financimi i huaj	209,096,316
Hendeku financiar 2024-2026	15,000,000

Analiza e Kostove	
Kosto Korente	14,330,300,887
Kosto kapitale	249,135,055
Total kosto	14,579,435,941

Shpenzimet e planifikuara për periudhën 2024-2026 në buxhetet e institucioneve përgjegjëse, janë planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Për periudhën 2024-2025, buxheti i shtetit pritet të financojë 14.35 miliardë lekë ose 99% të kostove indikative totale të planit për periudhën 2024-2026, ndërsa financimi i huaj është 209 milionë lekë ose 1% e kostove indikative. Hendeku financiar për këtë plan veprimi është në vlerën 15 milionë lekë.



Llogaritja e kostove të mësipërme është realizuar duke mbajtur në konsideratë se:

**Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur 109.5 Lekë për 1 Euro*

**Vlerat janë të shprehura në Euro dhe kundërvlera në Lekë*

MINISTRI

Taulant Balla